

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 165/2007  
19 maj 2009  
Prishtinë

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në Kolegjin e përbërë në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it (Ligji mbi Kompetencat);

I përbërë nga Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, Norbert Koster, Gjyqtar i EULEX-it, Fejzullah Hasani, Miftar Jasiqi dhe Agim Krasniqi, Gjyqtarë të Gjykatës Supreme, si anëtarë të kolegjit;

Të ndihmuar nga Judit Eva Tatrai, Zyrtare Ligjore e EULEX-it, si procesmbajtëse, Valentina Gashi dhe Patricia Faltusova, procesmbajtëse të EULEX-it, Shqipe Cavdarbasha, Edmond Laska, Leke Nimani, Mentor Abdullahu, Dominique Vorkapic-Kolic dhe Biljana Maric, përkthyes të EULEX-it;

Në prani të Prokurorëve Publikë, Anette Milk, Prokurore e EULEX-it, Theo Jacobs, Kryeprokuror i EULEX-it dhe Zyhra Ademi, Prokurore Publike, avokatit mbrojtës Aqif Tuhina, të pandehurit Mehmet Morina dhe palës së dëmtuar Radmila Trajković;

Në seancat e mbajtura më 21 prill dhe 19 maj 2009, dhe pas shqyrtimit të kolegjit të përfunduar më 19 maj 2009;

Në rastin penal kundër:

**Mehmet Morinës**, me nofkën Meha, Shqiptar-Kosovar, emri i babait Seidi Morina, emri i vajzërisë së nënës: Nazime Shabani, punëtor në autolarje, me banim në Rrugën Bese Nr. 21, Fushë Kosovë, i lindur më 11 gusht 1976 në Fushë Kosovë, i pamartuar, nuk ka të kryer shërbimin ushtarak, me gjendje të mesme ekonomike, di lexim por nuk di shkrim, është në paraburgim prej 19 prill 2004, momentalisht në Burgun e Dubravës;

I shpallur fajtor me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 22 korrik 2005, P. Nr. 493/2004 për veprën penale:

**Vrasje në tentativë**, në kundërshtim me nenin 30 paragrafi (2) pikat 1) dhe 5) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i SFRJ-së), lidhur me nenin 147 paragrafët (5) dhe (6) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe nenin 2 paragrafin (1) dhe nenin 23 të KPK-së;

I shpallur i pafajshëm dhe i liruar nga akuza për veprën penale **Pjesëmarrje në grup që kryen veprën penale**, në kundërshtim të nenit 200 të LPK-së, lidhur me nenin 320 të KPK-së;

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 165/2007  
Mehmet Morina



Dhe i dënuar me aktgjykimin e shkallës së parë me tetëmbëdhjetë (18) vite burgim, duke e llogaritur kohën e kaluar në paraburgim që nga data 19 prill 2004, në pritje të datës së aktgjykimit formës së prerë;

Duke vendosë mbi ankesën e avokatit mbrojtës Aqif Tuhina të parashtruar në dobi të të pandehurit Mehmet Morina, më 16 tetor 2006;

Duke vendosë po ashtu mbi ankesën e prokurorit publik në dëm të të akuzuarit, më 19 tetor 2006, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 22 korrik 2005, P. Nr. 493/2004;

Pas rishikimit të shkresave të gjykatës, dëgjimit të argumenteve të avokatëve mbrojtës dhe të prokurorit publik, dhe pas analizës së ligjeve në fjalë;

Sipas nenit 426 paragrafit (1) të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

**REFUZOHET** ankesa e prokurorit publik e parashtruar në dëm të të pandehurit Mehmet Morina më 19 tetor 2006;


**PRANOHET PJESËRISHT** ankesa e avokatit mbrojtës Aqif Tuhina, e parashtruar në dobi të të pandehurit Mehmet Morina, më 16 tetor 2006;

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i datës 22 korrik 2005, P. Nr. 493/2004 **NDRYSHOHET** ku kualifikimi i veprës penale për të cilën Mehmet Morina është shpallur fajtor është **Vrasje e rëndë në tentativë në bashkëpunim me persona tjerë**, e përcaktuar me nenin 30 paragrafin (2) pikën 3) të LPK-së lidhur me nenet 19 dhe 22 të KP i RSFJ-së;

I pandehuri Mehmet Morina dënohet për këtë veprë penale me **dymbëdhjetë (12) vjet burgim** ku është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim;

Pjesa e mbetur e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 22 korrik 2005, P. Nr. 493/2004 rikonfirmohet;

I pandehuri duhet të paguajë shpenzimet e procedurës penale.



Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 165/2007  
Mehmet Morina

## ARSYETIM

### I. Procedura

- Ankesat e paraqitura me kohë nga i pandehuri dhe Prokurori publik kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, më datën 22 korrik 2005, janë të papranueshme.
- Kolegji penal i shkallës së parë i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka qenë i përbërë nga gjyqtarë të UNMIK-ut, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/64 (të vazhduar deri më 15 dhjetor 2005, në përputhje me nenin 554, paragrafin 1 të KPPK-së me rregulloret pasuese të UNMIK-ut nr. 2001/34, 2002/20, 2003/36 dhe 2004/54).
- Gjykata Supreme e Kosovës, me përbërjen e përmendur më lart, është kompetente për të dhënë gjykimin e saj lidhur me ankesat e Prokurorit publik dhe të pandehurit Mehmet Morina.
- Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar drejt faktet materiale në aktgjykimin e tyre por në bazë të zbatimit të duhur të ligjit e në veçanti lidhur me masën e dënimit (neni 426 i KPPK-së), është dashur ta kalojë një aktgjykim tjetër.

### II. Bazat: Gjykata Supreme konsideron se:

- Gjyqtarët e shkallës së parë kanë përcaktuar drejt në aktgjykimin e tyre faktet materiale, të cilat janë bazë e ndjekjes penale dhe e aktakuzës.
- Në të vërtetë, duke u bazuar në deklaratën e rregullt të Dëshmitarit të Mbrojtur nr. 1 – DSh-1, të mbështetur nga rrethanat faktike të theksuara nga dëshmitari R. Williamson të cilat rezultojnë nga raportet e pakontestuara të policisë, në bazë të inspektimit okular nga Gjykata dhe në bazë të skicave të vizatuara në Gjykatë si dhe në bazë të observimit të bërë nga dëshmitari A. Namani, nga deklarata e palës së dëmtuar Radmila Trajkovic (e veja e viktimës Zlatibor Trajkovic) dhe duke pasur parasysh raportin mjeko-ligjor të patologut në lidhje me deklaratën e patologut të dhënë gjatë procedurës hetimore, gjyqtarët e shkallës së parë, në mënyrë ligjore kanë mundur të konstatojnë si më poshtë:

- i akuzuari Mehmet Morina, i identifikuar në mënyrë të rregullt, së bashku me personat e tjerë agresivë, ka goditur viktimën me një shufër metalike – “me të dy duart, ashtu si mbahet sëpata kur çahen drunjtë” – dhe të gjithë së bashku, plagosën për vdekje viktimën Zlatibor Trajkovic;
- qëllimi i të akuzuarit dhe i anëtarëve të këtij grupi agresiv, të cilët e goditën viktimën e pambrojtur duhet të karakterizohet si qëllim për vrasjen e viktimës, duke u mbështetur në mjetet (shufrat/shkopinj) e përdorura, mënyra si janë përdorur këto mjete e lëre më sjelljen e tyre penguese të drejtuar në veçanti ndaj ofrimit të ndihmës mjekësore viktimës që rrinte i shtrirë përtokë në kanal dhe i pambrojtur, i mbuluar në gjak;
- i akuzuari nuk ka qenë i përfshirë në djegien e viktimës që po vdiste (më vonë gjatë orëve të pasdites) por vetëm në rrahjen me shufër të viktimës, duke vepruar në

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 165/2007  
Mehmet Morina



bashkëveprim me të tjerët; nuk është vendosur asnjë afat serioz kohor që përcakton momentin e saktë kur i është vënë zjarri viktimës;

- edhe pse në raportin mjeko-ligjor vdekja është përshkruar si rezultat “i traumës në kokë DHE hipoksisë”, patologu ka nënvizuar faktin se viktimë ka qenë akoma gjallë kur i është vënë zjarri. Kjo gjë do të thotë se shkak i DREJTPËRDREJTË i vdekjes ishte “hypoxia tisularis për shkak të mungesës së oksigjenit dhe pranisë së monoksidit të karbonit gjatë zjarrit” dhe nga kjo rrjedhimisht del se goditja e shkaktuar nga i akuzuari nuk kishte lidhje të DREJTPËRDREJTË me vdekjen e viktimës Zlatibor Trajkovic, edhe pse viktimë ishte duke vdekur kur i ishte vënë zjarri kështu që i akuzuari përveç kësaj ishte drejtpërdrejt përgjegjës për faktin që viktimës nuk iu ofrua kujdesi i nevojshëm urgjent mjekësor;


- i akuzuari ka qenë shumë i vetëdijshëm se duke kryer ndaj viktimës goditjen me shufër në bashkëveprim me të tjerët, ai sigurisht që kishte rrezikuar jetën e viktimës prandaj kishte vepruar me paramendim siç edhe përshkruhet vepra penale e vrasjes.

### III Kualifikimi: Gjykata Supreme konsideron se:

- Gjyqtarët e shkallës së parë, duke u mbështetur në fakte, me të drejtë kanë kualifikuar sjelljen penale të të akuzuarit si tentativë e vrasjes së rëndë të Zlatibor Trajkoviqit, por në vend të pikës 3 të paragrafit 2 të nenit 30 të LPK-së, gjyqtarët e shkallës së parë iu kanë referuar pikave 1 dhe 5 të paragrafit 2 të nenit 30 të LPK-së, edhe pse këto pika (1 dhe 5) që përshkruajnë rrethanat objektive dhe subjektive të vrasjes (p.sh. në mënyrë mizore, të dhunshme, brutale, tinëzare etj), duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura dhe të konstatuara, nuk janë të zbatueshme *in casu*. Në vend të kësaj, është dashur të parashihen “motivet themelore” të të akuzuarit dhe bashkëvepruesve të tij, të cilat janë arsyet e nënvizuara të sjelljes kriminale gjatë marrjes së jetës së viktimës, edhe pse këto motive janë njohur edhe nga gjyqtarët e shkallës së parë (neni 30, paragrafi 2, pika 3 e LPK-së);

- Vërtet, elementet ligjore dhe në veçanti mungesa e lidhjes së drejtpërdrejtë në mes të goditjeve me shufra dhe vdekjes së viktimës, e shpjen Gjykatën Supreme deri tek përfundimi se sjellja kriminale duhet të kualifikohet si tentativë e vrasjes së rëndë dhe jo si vrasje e rëndë (e kryer). Në këtë kuptim, kjo Gjykatë konsideron se Zyra e Prokurorit, e cila nuk ka ushtruar ankesë që nga konfirmimi i aktakuzës, nuk ka bazë ligjore të kërkojë sot ndryshimin e kualifikimit në vrasje të rëndë, për arsye se që nga konfirmimi i aktakuzës asnjë element i ri faktik apo ligjor nuk mbështet një ndryshim të tillë të kualifikimit.

- Kolegji i shkallës së parë ka bërë zbatimin e duhur të dispozitave të nenit 2, paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës, me fjalë të tjera ka zbatuar ligjet në fuqi në kohën kur kanë ekzistuar këto fakte.



#### IV Dënimi: Gjykata Supreme merr parasysh peshën e dënimit:

- Brutaliteti dhe motivet themelore, të cilat e kanë frymëzuar përgjegjësin e këtij krimi, të akuzuar për kryerjen e veprimeve jonjerëzore kundër viktimës së pafajshme dhe të pambrojtur, paraqesin rrethana rënduese;

- Gjykata e shkallës së parë dhe zyra e prokurorit nuk kanë pasur respekt ndaj kujdesit të nevojshëm për zbatimin e drejtësisë me kohë. Afati i arsyeshëm kohor (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) nuk është respektuar dhe kjo rrethanë duhet të shkojë në dobi të të akuzuarit. Po ashtu, mungesa e dosjes së mëhershme kriminale dhe rrethanat familjare duhet të merren parasysh si rrethana lehtësuese.

- Si përfundim, Gjykata Supreme, shqipton dënimin e përmendur më sipër – d.m.th. dymbëdhjetë vjet burgim që është proporcionale me rrezikun e krimit dhe sjelljen e treguar kriminale të të akuzuarit, duke shpresuar gjithashtu se i akuzuari përfundimisht do ta kuptojë rëndesën e jashtëzakonshme, posaçërisht kur të kihet parasysh pasojat dramatike për familjen e viktimës, të shkaktuara nga sjellja e tij tërësisht kundër-sociale dhe jashtëzakonisht kriminele.

**PËR KËTË ARSYE, në përputhje me nenin 426 të KPPK-së, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.**

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 165/2007  
19 maj 2009  
Prishtinë

#### Anëtarët e Kolegjit:

Norbert Koster  
Gjyqtar i EULEX-it

Fejzullah Hasani  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Miftar Jasiqi  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

#### Kryetar i Kolegjit:

Guy Van Craen  
Gjyqtar i EULEX-it

Republika e Kosovës



Republika Kosovo

Agim Krasniqi  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme



PROCESBAPTËSE  
PUNKTORI I AUTORIZUAR  
OVLAŠĆENI RADNIK

Judit Eva Tatrai

Zyrtare Ligjore e EULEX-it

**Mendimi pjesërisht kundërshtues i Gjyqtarit Norbert Koster, në bazë të nenit 420, paragrafit 3 të KPPK-së**

Rasti në fjalë ngre çështje të vështira përkitazi me përgjegjësinë individuale penale. I akuzuari së bashku me personat tjerë si kryerës të paidentifikuar e rrah viktimën aq keq, saqë viktimë, tashmë i plagosur për vdekje, mbetet i shtrirë në një hendek. Pas një kohe të shkurtër, një tjetër kryerës i paidentifikuar vjen dhe derdh benzinë mbi viktimën akoma të gjallë dhe ia vë zjarrin. Viktimë vdes si rezultat edhe i rrahjes edhe i djegies. Secili veprim – edhe rrahja edhe djegia – vetvetiu do të kishin qenë të mjaftueshme për të shkaktuar vdekjen e viktimës.

Unë pajtohem plotësisht me kolegët e mi se i akuzuari ka vepruar duke pasur si qëllim privimin e jetës së viktimës, kur e kishte keqtrajtuar atë së bashku me bashkëkryerësit e tjerë. Gjithashtu, pajtohem plotësisht se i akuzuari nuk mund të mbahet përgjegjës që pak kohë më vonë viktimë edhe ishte djegur. Pasi nuk është e qartë nëse i njëjti ishte në dijeni për djegien e viktimës e lëre më nëse dëshironte ta ndërmernte një gjë të tillë si veprim të përbashkët, elementet e bashkëkryerjes me këtë kryerës nuk kanë mundur të konstatohen.

Përkundër kësaj, me gjithë respektin që kam për kolegët e mi unë nuk pajtohem me shumicën e tyre përkitazi me klasifikimin e veprës penale të kryer nga i akuzuari. Në mendimin tim, krimi i kryer nga ana e tij, nuk është vetëm e vrasje (e rëndë) në tentativë por është vrasje e plotë.

Neni 19 i KK të RSFJ-së – ligj në fuqi në kohën kur ndodhi krimi – përcakton veprën penale në tentativë si vijon:

“Çdokush që fillon një vepër penale me qëllim të kryerjes së saj por nuk e përfundon atë, do të dënohet për tentativën e vetëm atyre veprave penale .....

Një vlerësim i kujdesshëm i ngjarjeve dhe i veprimit të të akuzuarit në frymën e kësaj dispozite tregon se krimi i kryer nga ai ishte më shumë sesa vetëm një vrasje në tentativë.

I akuzuari, në bashkëveprim me të tjerët, rrahu viktimën dhe i shkaktoi lëndime të rënda ashtu që i njëjti vdiq brenda pak orësh. Raporti i autopsisë dhe dëshmia e ekspertit të mjekësisë ligjore dëshmojnë se rrahja nga i akuzuari dhe bashkëkryerësit e tij kishte shkaktuar disa fraktura të mëdha të kafkës të cilat jo vetëm që ishin aq serioze sa për ta shkaktuar vdekjen e viktimës por në fakt ishin një nga arsyet e vetë vdekjes së viktimës. Vlen të përmendet se sipas ekspertit të mjekësisë ligjore secila frakturë në vete do të kishte qenë fatale dhe se viktimë kishte vdekur “si rezultat i shokut neurogjenik për shkak të kontuzioneve encefalite, si pasojë e traumës të shkaktuar në kokë nga mjeti i topitur dhe hipoksisë së shkaktuar nga mungesa e oksigjenit dhe nga prania e monoksidit të karbonit gjatë zjarrit.”

Përballë një situatë si kjo, për mua është e qartë se neni 19 i KP të RSFJ-së nuk mund të aplikohet sepse vepra penale – privim i qëllimshëm i jetës së viktimës – është plotësuar përmes veprimeve, për të cilat mbahet përgjegjës i akuzuari.

Mbetet i diskutueshëm vetëm fakti nëse shkak i dytë i vdekjes së viktimës – lëndimet e shkaktuara më vonë nga procesi i djegies – kanë ndonjë ndikim në përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Një gjë e tillë duhet që të diskutohet në bazë të zinxhirit rastësor që është lidhja e domosdoshme në mes të veprimit të të akuzuarit (rrahja e viktimës) dhe rezultatit (vdekja e viktimës). Vetëm në qoftë se ky zinxhir rastësor është ndërprerë me veprimin e kryerësit të dytë, i akuzuari nuk do të ishte përgjegjës për plotësimin e vrasjes. Një ndërprerje e këtillë e këtij zinxhiri rastësor do të kushtëzonte se rrahja e kryer nga i akuzuari nuk do të mund të kishte efekt, ngase ishte ndërprerë nga një ndodhi e cila kishte filluar një zinxhir të ri rastësor. Një shembull i thjeshtë do të ishte ky: kryerësi A vendos bombën në veturën e viktimës ndërsa kryerësi B – në mënyrë të pavarur nga kryerësi A – vret viktimën para se viktima të hyjë në veturë. Në këtë rast, kryerësi A do të mbahej përgjegjës për vrasje në tentativë ngase zinxhiri rastësor i filluar nga veprimi i tij ishte ndërprerë nga vrasja para se të vinte gjer tek pasoja.

Rasti ynë, megjithatë, është dukshëm më ndryshe. Viktima vdiq si rezultat edhe i rrahjes edhe i djegies. Për këtë arsye, zinxhiri rastësor që ishte filluar nga veprimet e të akuzuarit nuk ishte ndërprerë apo mbyllur me ngjarjen e re të djegies. Në të kundërtën, që nga momenti i djegies të dy këta zinxhirë rastësorë po shkonin paralelisht njëri me tjetrin, duke përfunduar të dytë me vdekjen e viktimës. Unë jam i mendimit se në një situatë të tillë, zbatimi i nenit 19 të KK të RSFJ-së ndalohet për të dy kryerësit nga fakti se viktima vdiq si pasojë e veprimeve të secilit prej tyre dhe mjedhimisht nga kjo del se secili prej tyre është përgjegjës për vrasje të plotë të viktimës.

Çfarëdo rezultati tjetër do të shpinte në zgjidhje tjera që duken tejet arbitrare. Po qe se krimi i të akuzuarit do të klasifikohet si një tentativë e thjeshtë, çfarë do të ishte klasifikimi për krimin e kryer nga kryerësi tjetër, d.m.th. djegien e viktimës? A do të ishte edhe kjo vetëm një tentativë e thjeshtë e vrasjes? Kjo do të ishte e papranueshme pasi që në mënyrë të qartë do t'i shkelte parimet e logjikës duke pasur vetëm kryerës të vrasjes në tentativë edhe pse viktima vdiq mu si rezultat i keqtrajtimit të tyre. A do të ishte kjo një vrasje e plotë? Në shikim të parë, një gjë e tillë duket më e logjikshme, por përnjëherë lindin pyetje të tjera. Për çfarë arsye kryerësi i dytë do të ishte përgjegjës për vrasje të plotë, përderisa kryerësi i parë është përgjegjës vetëm për vrasje në tentativë? Pse të mos ishte e kundërta, d.m.th. kryerësi i parë i cili shkaktoi arsyen e parë dhe të pakthyeshme për vdekjen e viktimës të jetë përgjegjës për vrasje të plotë, ndërsa i dyti të jetë përgjegjës vetëm për vrasje në tentativë?

Me fjalë të tjera: po qe se, siç ndodhi në rastin tonë, viktima vdes si rezultat edhe i rrahjes edhe i djegies, për çfarë arsye i akuzuari të përfitojë nga djegia, ndërsa zjarrvënësi nga rrahja? Nuk ekzistojnë kritere të cilat do të mundësonin konstatimin e niveleve të

ndryshme të përgjegjësive penale në një mënyrë të arsyeshme. Të dy bashkëkryerësit kanë kryer vepra njësoj të rënda dhe të dytë duhet të fajësohen për vdekjen e viktimës. Nga kjo del se të dytë janë fajtorë për vrasje të plotë.

Për këtë arsye, unë jam i mendimit se aktgjykimi i shkallës së parë është dashur të ndryshohet me klasifikimin e krimit të kryer nga i akuzuari si vrasje e përfunduar. Po ashtu, ndaj mendimin se duke iu falënderuar ankesës së prokurorisë, kolegji në pajtim me nenin 426, paragrafin 1 dhe me nenin 386, paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, do të ishte në pozitë që ta ndryshonte aktgjykimin në përputhje me këtë edhe po qe se prokuroria nuk do ta ndryshonte aktakuzën.

---

**Norbert Koster**

**Gjyqtar i EULEX-it**